

UDHËZIM
Nr. 12, datë 10.6.2021

PËR PROCEDURAT E PRANIMIT, TË PEZULLIMIT DHE TË LARGIMIT TË MËSUESIT DHE TË MËSUESIT NË DISPOZICION NGA NJË VEND PUNE, SI DHE ADMINISTRIMI I PORTALIT “MËSUES PËR SHQIPËRINË”

(ndryshuar me udhëzimin nr. 23, datë 1.12.2021; nr. 28 datë 3.8.2022; nr. 17, datë 26.7.2023; nr. 25, datë 1.12.2023)

(i përditësuar)

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 60, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

UDHËZOJ:

KREU 1
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky udhëzim rregullon procedurat e pranimit, të pezullimit dhe të largimit të mësuesit dhe të mësuesit në dispozicion nga një vend pune, si dhe administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë”.

2. Shpallja e vendeve të lira të punës, konkurrimi, renditja e kandidatëve për mësues apo mësues në dispozicion, si dhe pranimi në një vend të lirë pune realizohen nëpërmjet portalit “Mësues për Shqipërinë”.

3. Procedurat udhëhiqen nga parimet e ligjshmërisë e të përgjegjshmërisë, si dhe nga vlerat e profesionalizmit, transparencës, meritës, së drejtës për zgjedhjen e institucionit arsimor, barazisë dhe interesit më të lartë të nxënësve.

4. Procedurat sipas këtij udhëzimi zbatohen vetëm për kandidatët që plotësojnë kriteret e përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për ushtrimin e profesionit të mësuesit.

5. Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar (në vazhdim DPAP) është përgjegjëse për procedurat e konkurrimit dhe të pranimit të mësuesit në një vend të lirë pune në sistemin e arsimit parauniversitar, ndërsa drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar (në vazhdim DRAP) organizojnë procedurat sipas këtij udhëzimi.

6. DRAP-et, bazuar në të dhënat e dërguara nga ZVAP-et, shpallin vendet e lira të punës për lëvizjet paralele jo më vonë se 1 muaj para fillimit të vitit shkollor dhe gjatë vitit menjëherë nga njoftimi për vendin e lirë të punës. DRAP-et njoftojnë DPAP-në brenda 2 (dy) ditëve pune për vendet e shpallura.

7. Vendet e lira të punës në përfundim të vitit shkollor, shpallen pasi janë sistemuar mësuesit që mbeten pa ngarkesë mësimore (lëvizje e detyruar paralele) dhe pasi është bërë plotësimi i kërkesave për lëvizje paralele me dëshirë, deri në 10 (dhjetë) ditë para fillimit të vitit mësimor.

8. Mësuesi i nënshtrohet lëvizjes paralele vetëm pasi të ketë kryer 1 (një) vit kalendarik të plotë pune në institucionin arsimor parauniversitar, ku ka marrë emërimin me afat të pacaktuar.

9. ZVAP-të dërgojnë në DRAP 10 (dhjetë) ditë përpara fillimit të vitit shkollor listën e mësuesve të punësuar me procedurën e lëvizjes paralele dhe e publikojnë atë në faqen zyrtare të tyre dhe në stendat e informimit publik. DRAP e publikon këtë listë në faqen elektronike zyrtare të saj dhe e dërgon në DPAP, jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë përpara fillimit të vitit shkollor.

10. DRAP publikon në faqen elektronike zyrtare të institucionit listën me vendet e lira, provizore, me ngarkesë të plotë ose me të pjesshme, për vitin shkollor në vijim, jo më vonë se 7 (shtatë) ditë para fillimit të vitit shkollor dhe e dërgon në DPAP brenda 1 (një) ditë pune.

11. DPAP-ja publikon në faqen elektronike zyrtare të saj listën e mësuesve që janë emëruar me lëvizje paralele dhe listën me vendet e lira provizore, me ngarkesë të plotë ose me të pjesshme, dhe i dërgon për publikim në faqen e portalit “Mësues për Shqipërinë”.

12. DRAP-ja ka detyrimin të pasqyrojë menjëherë në portalin “Mësues për Shqipërinë”, gjatë vitit shkollor, vendet e lira të punës për çdo institucion arsimor parauniversitar sipas ZVAP-ve në juridiksionin e saj, si dhe listën e punësimeve të kryera në muajin paraardhës, brenda 5 (pesë) ditëve të para të çdo muaji i dërgon në DPAP dhe në MASR.

KREU 2 KONKURRIMI

1. Kandidatët kanë të drejtë të konkurrojnë deri në tri ZVAP në gjithë territorin.
2. Konkurrimi zhvillohet në dy faza:
 - a) vlerësim me dosje;
 - b) testim i informatizuar.
3. Në fazën e parë, kandidati i interesuar për të ushtruar profesionin e mësuesit ngarkon në platformën e aplikimit *online* dokumentet për konkurrim. Një kopje të dokumentacionit të ngarkuar *online* e dërgon në DRAP ku ai ka qendrën e banimit, për efekt të vlerësimit të dosjes.
4. Lista e dokumenteve që duhet të përmbajë dosja e aplikimit, është sipas shtojcës 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe pjesë përbërëse e tij.

4/1 Mësuesi nuk mund të punësohet dhe, kur është i punësuar, përfundon marrëdhënien e punës në rast se:

 - a) është i regjistruar në Regjistrin Kombëtar të të Dënuarave për Krime Seksuale; ose
 - b) është dënuar me vendim penal të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale të përcaktuar me udhëzim të ministrit përgjegjës për arsimin, që, për shkak të natyrës së veprës së kryer, diskrediton pozitën dhe figurën e punonjësit arsimor ose dëmton rëndë besimin e publikut në sistemin arsimor, pavarësisht nëse është rehabilituar sipas parashikimeve të Kodit Penal.
5. Kandidati, dosja e të cilit nuk përmban dokumentet e detyrueshme për t'u ngarkuar *online* sipas shtojcës 1, nuk kalon në fazën tjetër të konkurrimit.
6. Kandidati i interesuar, për të ushtruar profesionin e mësuesit duhet të regjistrohet *online* në portalin “Mësues për Shqipërinë”, duke iu nënshtruar të dyja fazave të konkurrimit sipas procedurave dhe afateve të përcaktuara në këtë udhëzim.

6/1. Kandidati i interesuar për të ushtruar profesionin e mësuesit, që zotëron më shumë se një licencë, ka të drejtë të aplikojë dhe të regjistrohet online në portalin “Mësues për Shqipërinë”, për profilet e mësuesisë sipas licencave që zotëron.
7. Kandidati, i cili ka qenë pjesëmarrës në portalin e fundit dhe dëshiron të konkurrojë, duhet të ngarkojë *online* dosjen për konkurrim. Në të kundërt, ai përjashtohet nga konkurrimi. Një kopje të kërkesës për konkurrim, sipas shtojcës 4 të këtij udhëzimi, kandidati e dorëzon edhe në DRAP-në ku ka qendrën e banimit.
8. Në portal, kandidati zgjedh një nga opsionet:
 - a) aplikoj për herë të parë; b) mbart pikët aktuale (dosje+testim); c) mbart vetëm pikët e dosjes; d) mbart vetëm pikët e testimit. Në fazën e dytë, “Testim i informatizuar”, marrin pjesë kandidatët që janë regjistruar *online* në portalin “Mësues për Shqipërinë” dhe që kanë kaluar me sukses fazën e parë “Vlerësim me dosje”.
9. Për të marrë pjesë në testimin e informatizuar, kandidati duhet të pajiset me formularin e printuar nga sistemi *online*, sipas shtojcës 3 të këtij udhëzimi, të cilin e paraqet në Qendrën e Shërbimeve Arsimore (në vazhdim “QSHA”) ditën e testimit.

9/1 Në momentin e aplikimit kandidati që dëshiron të punësohet si mësues në dispozicion zgjedh opsionin “Pranoj të punësohem si mësues në dispozicion”.
10. Nëse kandidati ngarkon në platformën e aplikimit *online* dokumente të falsifikuara, përjashtohet nga pjesëmarrja në testim dhe dërgohet për ndjekje penale në organet përkatëse nga organi që e ka konstatuar.
11. Rezultatet përfundimtare të vlerësimit të dosjes dhe të testimit të informatizuar për çdo kandidat bëhen transparente nëpërmjet faqes elektronike zyrtare të çdo DRAP/ZVAP-je dhe në portalin “Mësues për Shqipërinë”.
12. Çdo DRAP dhe ZVAP, pas marrjes së rezultatit nga Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar (në vazhdim “RASH”), ka detyrimin të shpallë në faqen elektronike zyrtare dhe në standat e informimit publik listat e kandidatëve me kodet përkatëse të siguruara nga RASH-i në momentin e aplikimit, të renditur sipas profileve, për institucionet arsimore parauniversitare në juridiksionin e tyre.
13. Renditja e kandidatëve, të cilët kanë përfunduar të dyja fazat e konkurrimit, fillon me kandidatin që ka më shumë pikë dhe vijon me rend zbritës për çdo profil dhe çdo ZVAP.

Mësuesit që kanë zgjedhur edhe opsionin mësues në dispozicion, renditen në një listë të veçantë sipas profileve për mësues në dispozicion në ZVAP-të ku kanë aplikuar.

14. Renditja e kandidatëve shpallet në portalin “Mësues për Shqipërinë” dhe në faqen elektronike zyrtare të DPAP-së.

15. DPAP-ja dërgon elektronikisht dhe me shkresë zyrtare në DRAP, ZVAP dhe MASR listën me rezultatet përfundimtare dhe renditjen e kandidatëve sipas çdo profili/lënde, pas përfundimit të të gjitha fazave të konkurrimit dhe ankimit.

16. Administrimi i listës së kandidatëve bëhet nga DRAP-ja dhe ZVAP-ja sipas renditjes dhe profileve të shpallura në portal nga DPAP-ja.

KREU 3

ADMINISTRIMI I PORTALIT “MËSUES PËR SHQIPËRINË”

1. RASH-i garanton që portali “Mësues për Shqipërinë” të krijojë llogari për anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Dosjeve (KVD) që do të vlerësojnë *online* dosjet për konkurrim, mundëson hedhjen e pikëve të dosjes së çdo aplikanti duke e lidhur me ID-në e personit, si dhe siguron kalimin *online* të pikëve të testimit elektronik nga QSHA-ja në llogarinë personale të aplikantit.

2. RASH-i është përgjegjës për administrimin e softit elektronik të portalit “Mësues për Shqipërinë” dhe të regjistrimit *online* të kandidatit për të marrë pjesë në konkurrim.

3. Hedhja e rezultateve të kandidatëve nga vlerësimi i dosjeve bëhet nga DRAP-ja në llogaritë e hapura nëpërmjet funksionalitetit në portalin “Mësues për Shqipërinë”.

4. RASH-i, nëpërmjet portalit “Mësues për Shqipërinë”:

a) zbaton funksionalitetin që ngarkon rezultatet e testimit të informatizuar që i përcillen zyrtarisht nga QSHA-ja;

b) zbaton funksionalitetin që bën renditjen e kandidatëve sipas pikëve totale (shuma e pikëve të dosjes dhe e pikëve të testimit) për kandidatët për çdo ZVAP dhe për çdo profil;

b/1 zbaton funksionalitetin që bën renditjen e kandidatëve për mësues në dispozicion sipas përzgjedhjes së opsionit “mësues në dispozicion” dhe pikëve totale (shuma e pikëve të dosjes dhe e pikëve të testimit) për kandidatët për çdo ZVAP dhe për çdo profil;

c) vë në dispozicion të ZVAP-së funksionalitetin për pranimin ose refuzimin e një vendi pune nga ana e kandidatit;

d) RASH heq nga lista e renditjes në portal vetëm për atë ZVAP, kandidatët që janë punësuar në vende pune vakant dhe me ngarkesë të plotë pas prodhimit të aktit të pranimit të vendit vakant të punës.

5. RASH-i garanton që portali “Mësues për Shqipërinë” prodhon aktin e pranimit të vendit të punës.

KREU 4

KOMISIONI I VLERËSIMIT TË DOSJEVE

1. DRAP-ja krijon Komisionin e Vlerësimit të Dosjeve (në vazhdim “KVD”), me këtë përbërje:

a) drejtori i DRAP-së (kryetar);

b) një përfaqësues i sektorit të burimeve njerëzore, shërbimeve dhe statistikës (anëtar);

c) dy përfaqësues të sektorit të kurrikulës dhe zhvillimit profesional (anëtarë);

d) një mësues nga institucionet e arsimit parauniversitar në ZVAP-të në juridiksion të DRAP-së, i cili ka të paktën kategorinë e kualifikimit “Mësues specialist” dhe vlerësohet për profesionalizëm e korrektësi në ushtrimin e profesionit (anëtar).

2. KVD-i përzgjedh një apo më shumë anëtarë si sekretari teknike për mbajtjen e të dhënave dhe të dokumentacionit të aplikantëve.

3. KVD-i zbaton rregulloren e brendshme të tij, të miratuar nga drejtori i DRAP-së dhe detyrat e mëposhtme:

a) administron dokumentacionin e kandidatëve për mësues;

b) njofton përfaqësuesit e sindikatave si vëzhgues në mbledhjet e komisionit;

- c) shqyrton plotësimin e kriterëve ligjore të çdo kandidati për të ushtruar profesionin e mësuesit;
 - d) vlerëson me pikë, sipas shtojcës 2, dokumentacionin e paraqitur nga kandidatët;
 - e) harton listën për çdo profil/lëndë sipas çdo ZVAP-je me ID-të përkatëse;
 - f) publikon në faqen elektronike zyrtare pikët e dosjeve për çdo kandidat, me kodin përkatës të gjeneruar nga RASH-i, sipas profileve për çdo ZVAP;
 - g) dërgon elektronikisht dhe zyrtarisht në DPAP listën përfundimtare me pikët e dosjes të çdo kandidati sipas profileve dhe kandidatëve të skualifikuar.
4. Skema e vlerësimit të dosjes së kandidatëve për ushtrimin e profesionit të mësuesit përcaktohet në shtojcën 2, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.
5. Anëtari i KVD-së duhet të verifikojë dhe të shmangë konfliktin e interesit me kandidatët nëpërmjet vetëdeklarimit.

KREU 5

APLIKIMI DHE PROCEDURA E VLERËSIMIT TË DOSJEVE PËR KANDIDATËT E ARSIMIT PARASHKOLLOR

1. Kandidatët e profilit të arsimit parashkollor aplikojnë në portal sipas përcaktimeve të këtij udhëzimi.
2. Kandidatët e profilit të arsimit parashkollor dërgojnë me postë në ZVAP ku kanë vendbanimin, dosjen sipas shtojcës 1 të cilën e kanë ngarkuar *online*, sipas afateve të përcaktuara.
3. ZVAP-ja krijon komisionin e vlerësimit të dosjeve (në vazhdim “KVD”), për vlerësimin e dosjeve të aplikantëve të arsimit parashkollor, me këtë përbërje:
 - a) drejtori i ZVAP-së (kryetar);
 - b) një përfaqësues i sektorit të kurrikulës (anëtar);
 - c) dy përfaqësues të njësisë së vetëqeverisjes vendore (anëtarë);
 - d) një mësues nga institucionet e arsimit parashkollor të njësisë së vetëqeverisjes vendore ku ndodhet ZVAP-ja, i cili ka të paktën kategorinë e kualifikimit “Mësues specialist” dhe vlerësohet për profesionalizëm e korrektësi në ushtrimin e profesionit (anëtar);
4. KVD-i përzgjedh një apo më shumë anëtarë si sekretari teknike për mbajtjen e të dhënave dhe të dokumentacionit të aplikantëve.
5. KVD-i zbaton rregulloren e brendshme të tij, të miratuar nga drejtori i ZVAP-së, dhe detyrat e mëposhtme:
 - a) administron dokumentacionin e kandidatëve për mësues;
 - b) shqyrton plotësimin e kriterëve ligjore të çdo kandidati për të ushtruar profesionin e mësuesit;
 - c) vlerëson me pikë, sipas shtojcës 2, dokumentacionin e paraqitur nga kandidatët;
 - d) publikon në faqen elektronike zyrtare pikët e dosjeve për çdo kandidat, me kodin përkatës të gjeneruar nga RASH-i;
 - e) dërgon elektronikisht dhe zyrtarisht në DRAP listën përfundimtare me pikët e dosjes të çdo kandidati dhe kandidatëve të skualifikuar.
6. DRAP-ja ngarkon në portal pikët e secilit kandidat sipas listës së dërguar nga KVD-ja për kandidatët e arsimit parashkollor.
7. Anëtari i KVD-së duhet të verifikojë dhe të shmangë konfliktin e interesit me kandidatët nëpërmjet vetëdeklarimit.

KREU 6

IDENTIFIKIMI I VENDEVE TË LIRA TË PUNËS

1. Vend i lirë pune do të konsiderohet çdo ngarkesë mësimore sipas udhëzimit përkatës të ministrit përgjegjës për arsimin, pavarësisht nëse është në një apo në disa institucione arsimore parauniversitare. Në rast se ngarkesa mësimore është në disa institucione arsimore parauniversitare, mësuesi punësohet nga drejtori i institucionit arsimor ku ka më shumë ngarkesë mësimore.

2. Punësimi në një vend të lirë pune me kohëzgjatje të pacaktuar duhet të ruajë vijimësinë e ngarkesës mësimore edhe për vitin shkollor pasardhës.

3. *ZVAP-të, në bashkëpunim me drejtoritë e LA-ve publike, identifikojnë vendet e lira të punës që krijohen në LAP pas përfundimit të procesit të regjistrimit të nxënësve si dhe gjatë vitit shkollor.*

KREU 7

PROCEDURAT PËR LËVIZJET PARALELE

1. Në përfundim të vitit shkollor procedurat e lëvizjes paralele administrohen nga ZVAP-ja, vetëm për mësues që ushtrojnë profesionin e mësuesit në institucionet arsimore parauniversitare, brenda juridiksionit të ZVAP-së, sipas listës së aplikimeve të vlerësuara në periudhën e përcaktuar në udhëzim.

2. Mësuesi që dëshiron të kryejë lëvizje paralele në përfundim të vitit shkollor, dërgon me postë në ZVAP kërkesën dhe dokumentacionin e njëzuar me origjinalin sipas shtojcës 2.1 të këtij udhëzimi.

3. Dorëzimi i dosjeve për lëvizje paralele bëhet sipas afateve të përcaktuara nga DPAP-ja.

4. Për lëvizje paralele mund të aplikojnë edhe mësuesit e kulturës së përgjithshme të institucioneve të arsimit të mesëm profesional që janë punësuar nga portali “Mësues për Shqipërinë”, ose para hyrjes në fuqi të portalit.

5. *Për mësuesit që mbeten pa ngarkesë mësimore, drejtori i LAP-së dërgon në ZVAP listën emërore, dokumentacionin e njëzuar me origjinalin dhe vlerësimin e dosjes, sipas shtojcës 2.1 të këtij udhëzimi brenda muajit gusht.*

6. ZVAP-ja krijon komisionin e vlerësimit të dosjeve për lëvizje paralele, me këtë përbërje:

a) drejtuesi i ZVAP-së (kryetar);

b) një specialist i kurrikulës dhe zhvillimit profesional në ZVAP (anëtar);

c) juristi i ZVAP-së (anëtar).

7. Komisioni i vlerësimit të dosjeve në ZVAP bën vlerësimin e dosjeve të kandidatëve për lëvizje paralele sipas shtojcës 2.1 të këtij udhëzimi, *brenda muajit gusht.*

8. Komisioni i vlerësimit të dosjeve shpall renditjen e konkurrentëve për lëvizje paralele sipas pikëve në rendin zbritës. Lista me renditjen e mësuesve shpallet në faqen elektronike zyrtare të ZVAP-së, e cila dërgon një kopje të listës në DRAP dhe DPAP. Kjo listë do të jetë në fuqi deri në vlerësimin e kërkesave për lëvizje paralele të vitit shkollor pasardhës.

9. Mësuesi i renditur me numrin më të madh të pikëve, ka të drejtën e zgjedhjes për vendin e lirë të punës. Ai dërgon brenda 24 orëve me *e-mail* miratimin ose refuzimin e vendit të propozuar. Në rast të moskonfirmimit nga kandidati, ky vend pune i ofrohet mësuesit të listuar një rend më poshtë. Nëse për një vend pune janë dy mësues me pikë të barabarta, përzgjedhja bëhet duke vlerësuar me radhë: vjetërsinë në punë, shkallën e kualifikimit, vlerësimin e kualifikimit të fundit dhe, në rastin kur dy mësuesit përsëri rezultojnë me tregues të njëjtë, me short.

10. Kur në një institucion arsimor bie numri i ngarkesës mësimore për një profil/lëndë, drejtori i IAP-së krijon komisionin për shqyrtimin dhe vlerësimin e dosjeve të të gjithë mësuesve të atij profili/lënde.

11. Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e dosjeve në shkollë përbëhet nga drejtori i shkollës (kryetar), një mësues i atij institucioni arsimor parauniversitar që vlerësohet për profesionalizëm e korrektësi në profesion (anëtar) dhe kryetari i këshillit të prindërve të po atij institucioni arsimor parauniversitar (anëtar). Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e dosjeve në institucionin arsimor parauniversitar ka për detyrë të bëjë vetëm vlerësimin e dosjeve të mësuesve të profilit/lëndës, për të cilën bie numri i orëve sipas shtojcës 2.1 të këtij udhëzimi, dhe të publikojë në mjediset e institucionit rezultatet me ID-të përkatëse.

12. Mësuesve që rezultojnë pa ngarkesë mësimore dhe mbeten të pasisteluar, si pasojë e mungesës së vendeve të punës, u ndërpritet marrëdhënia e punës me të drejtën e konkurrimit sipas këtij udhëzimi.

13. Mësuesit që kanë bërë kërkesë për lëvizje paralele dhe mësuesit që kanë rezultuar pa ngarkesë mësimore, në rastet kur sistemohen në një vend pune të lirë, punësohen me kontratë pune me kohëzgjatje të pacaktuar.

14. Mësuesi, i cili është në marrëdhënie pune dhe dëshiron të kryejë lëvizje paralele gjatë vitit shkollor, duhet të regjistrohet *online* në portalin “Mësues për Shqipërinë” dhe t’u nënshtrohet të dy fazave të konkurrimit, sipas dispozitave të *krerëve 2, 4, 5 dhe 8*, të këtij udhëzimi, si dhe ruan vendin e punës pavarësisht rezultatit të arritur.

KREU 8 PROCEDURAT E PUNËSIMIT TË MËSUESVE

1. Komisioni i vlerësimit të dosjeve për lëvizjet paralele, i ngritur në ZVAP, ndjek procedurat e punësimeve nga portali dhe dërgon informacion në institucionet arsimore parauniversitare përkatëse.

2. Vendet e lira të punës, të paplotësuara në përfundim të vitit shkollor u ofrohen në fillim mësuesve nga lista për lëvizje paralele brenda ZVAP-së, sipas renditjes.

3. Për një vend të lirë pune, kandidati njoftohet nga ZVAP-ja përmes postës elektronike, të cilën kandidati e ka deklaruar gjatë aplikimit *online*. ZVAP-ja nuk ka përgjegjësi, nëse adresa e *e-mail*-it e kandidatit nuk është deklaruar e saktë.

4. Kandidati që në renditjen e përgjithshme ka numrin më të madh të pikëve, ka të drejtën e zgjedhjes për vendin e lirë të punës dhe është i detyruar të konfirmojë në ZVAP brenda 24 orëve nëpërmjet adresës elektronike. Nëse kandidati nuk konfirmon, ky pozicion pune i ofrohet kandidatit të listuar një rend më poshtë. Midis kandidatëve që rezultojnë me pikë të barabarta, përparësi ka kandidati që mund të jetë në kategorinë e personave me aftësi të kufizuara. Në rast se nuk ka persona me aftësi të kufizuara, vendi i lirë i punës i ofrohet kandidatit që ka rezultatin më të lartë në testim. Nëse edhe pikët e testimit janë të njëjta, kandidatët përzgjidhen duke vlerësuar me radhë: vjetërsinë në punë, notën mesatare të shkollës, shkallën e kualifikimit dhe vlerësimin e kualifikimit të fundit dhe, në rastin kur përsëri rezultojnë me tregues të njëjtë, me short.

5. Kandidati nuk mund të refuzojë më shumë se tri vende pune të lira me afat të pacaktuar në tri njoftime të njëpasnjëshme të ZVAP-së.

6. Kandidati fitues paraqitet në institucionin arsimor parauniversitar ku ofrohet vendi i lirë i punës menjëherë sapo merr njoftimin. Ai i dorëzon drejtorit të institucionit dokumentin vërtetues, të printuar nga sistemi i aplikimit *online* në portalin “Mësues për Shqipërinë”.

7. Mësuesit ndihmës do të punësohen nga kandidatët e portalit “Mësues për Shqipërinë” të profilit “Arsim special”, sipas procedurave të këtij udhëzimi.

8. *Kandidati fitues punësohet nga drejtori i institucionit arsimor parauniversitar me kontratë pune individuale, me ose pa afat, sipas kërkesave të vendit të lirë të punës, pas kalimit me sukses të periudhës tremujore të provës dhe të vlerësimit pozitiv nga komisioni për vlerësimin psikosocial të punonjësve arsimorë dhe punonjësve të tjerë në institucionet arsimore parauniversitare.*

9. Pas lidhjes së kontratës, i punësuari dorëzon dosjen personale me të gjitha elementet e saj përbërëse në ZVAP dhe në IAP-në ku lidhet kontrata.

10. DRAP-ja, brenda datës 5 (pesë) të çdo muaji, njofton zyrtarisht DPAP-në për punësimet me afat të caktuar apo të pacaktuar të bëra nga drejtorët e IAP-ve në juridiksionin e saj.

11. *Çdo kandidat që ka përzgjedhur një vend pune me ngarkesë të plotë dhe është emëruar me kontratë pune pa afat, i ndryshon statusi në portal në statusin i punësuar dhe nuk qëndron më në renditjen e portalit “Mësues për Shqipërinë” për atë ZVAP.*

12. Çdo kandidati të emëruar me kontratë pune me afat, i ndryshon statusi në portal në statusin “i punësuar përkohësisht” dhe i ofrohet çdo vend tjetër në vijim.

KREU 8/1
PROCEDURAT E PUNËSIMIT PËR MËSUESIT NË DISPOZICION
(shfuqizuar pika 9 me udhëzim nr. 25, datë 1.12.2023)

1. Kandidatët, të cilët dëshirojnë të punojnë si mësues në dispozicion në momentin e aplikimit, zgjedhin në portalin “Mësues për Shqipërinë” opsionin “Mësues në dispozicion”. Në rastin kur kandidati zgjedh edhe opsionin “Mësues në dispozicion”, plotëson shtojcën 8, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.
2. ZVAP-ja para fillimit të vitit të ri shkollor, bën rakordimin ndërmjet parashikimit të nevojave dhe numrit të miratuar të punonjësve të saj, për të planifikuar numrin e mësuesve në dispozicion sipas fushave/profileve.
3. ZVAP-ja, çdo fillim viti shkollor publikon listën e kandidatëve që kanë zgjedhur të punësohen si mësues në dispozicion, të cilët renditen sipas profileve për ZVAP-në ku kanë aplikuar.
4. Punësimi i mësuesve në dispozicion bëhet nga titullari i institucionit arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar (ZVAP-ja), sipas renditjes në portal.
5. Vendet e lira të punës, në pozicionin mësues në dispozicion, u ofrohen në fillim mësuesve që dalin pa ngarkesë mësimore dhe nuk janë sistemuar, sipas renditjes.
6. ZVAP-ja, sipas nevojave, emëron mësuesin, i cili nënshkruan kontratën e punës dhe pranon këtë pozicion pune. Kjo kontratë do të jetë deri në përfundim të vitit shkollor.
7. Mësuesi në dispozicion ka të drejtë të zgjidhë kontratën si mësues në dispozicion, nëse atij i ofrohet vendi i punës në profilin përkatës.
8. Mësuesi në dispozicion që ka nënshkruar kontratën, duhet të jetë i gatshëm në ZVAP çdo mëngjes për t'u punësuar sipas kërkesave që vijnë nga drejtuesit e LA-ve, për zëvendësim, rast pas rasti.
9. Shfuqizuar.

KREU 9
PROCEDURAT E PUNËSIMIT PËR RASTE TË VEÇANTA

1. Kur në një ZVAP nuk ka kandidatë të renditur në portal, sipas profilin që përkon me vendin e lirë të punës, njoftohen dhe emërohen kandidatët e renditur në portal në një profil të përafërt me profilin e kërkuar, duke respektuar procedurat e këtij udhëzimi.
2. Profili i përafërt përcaktohet sipas udhëzimit të ministrit përgjegjës për arsimin që përcakton numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar.
3. Në mungesë të kandidatëve të profilin “Arsim special”, për plotësimin e vendeve të lira për mësues ndihmës, ZVAP-ja vepron si më poshtë:
 - a) nëse nga IAP-të do të kërkohen mësues ndihmës në arsimin fillor, ZVAP-ja do të njoftojë për punësim kandidatët nga portali “Mësues për Shqipërinë” në profilin “Arsim fillor” sipas renditjes;
 - b) nëse nga IAP-të do të kërkohen mësues ndihmës në arsimin e mesëm të ulët ose në arsimin e mesëm të lartë, ZVAP-ja do të njoftojë për punësim kandidatët nga portali “Mësues për Shqipërinë” të të gjitha profileve duke i renditur të gjithë kandidatët e të gjitha profileve dhe do të punësojë kandidatët që kanë renditjen më të mirë.
4. Për institucionet arsimore parauniversitare të arsimit të mesëm të lartë të orientuar, profilet e artit pamor dhe muzikës, në lëndët e specialiteteve punësohen specialistë që janë renditur në portal sipas titullit të diplomës. Kjo kategori mund të punësohet edhe në arsimin e mesëm të ulët për lëndët e artit pamor dhe muzikës sipas renditjes së përgjithshme.
5. Deri në plotësimin e vendit të lirë të punës nga lista e portalit të ZVAP-së, ose nga kandidatët e portalit nga të gjitha ZVAP-të në varësi të DRAP, bëhet punësimi me afat të caktuar me kandidatë të tjerë të profilin të përafërt në ZVAP dhe në mungesë të tyre me kandidatë të interesuar të këtij profili ose profili i përafërt, të cilët kanë paraqitur kërkesë në ZVAP, duke bërë renditjen e tyre. Lista e kandidatëve të kësaj kategorie bëhet publike në faqen elektronike zyrtare të ZVAP-së, dërgohet në DRAP, 5 ditë para fillimit të vitit shkollor. DRAP dërgon zyrtarisht në DPAP listën e kandidatëve të punësuar për këtë kategori 5 ditë pas fillimit të vitit shkollor dhe brenda 5 ditëve të para të çdo muaji, nëse gjatë vitit shkollor ka punësime të tilla.
6. Kontrata e punës për kategorinë e mësuesve të përcaktuar në pikat 3, 4 dhe 5, të këtij kreu, lidhet me afat të caktuar, deri në momentin e paraqitjes së një kandidati nga portali

“Mësues për Shqipërinë”, por në asnjë rast jo më shumë se 10 ditë pune pas përfundimit të vitit mësimor, sipas udhëzimit të ministrit.

KREU 10 PEZULLIMI DHE LARGIMI NGA PUNA I MËSUESIT

1. Drejtori i LAP-së merr masën e pezullimit ndaj mësuesit, në rastet si më poshtë:

a) gjykata ka vendosur masat e sigurimit personal;

b) mësuesi është në proces hetimi për kryerjen e një vepre penale sipas nenit 60/1 të ligjit nr. 69/2012, i ndryshuar.

2. Mësuesit të pezulluar i ndërpriten marrëdhëniet financiare për kohën e pezullimit. Masa e pezullimit përfundon me shuarjen e shkaqeve të pezullimit ose të largimit nga detyra. Rastet e tjera të pezullimit nga detyra të mësuesit përcaktohen në aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.

3. Mësuesi largohet nga detyra:

a) nëse në fund të procesit gjyqësor dënohet nga gjykata me vendim të formë së prerë me burgim për kryerjen e një vepre penale;

b) nëse në fund të procesit gjyqësor dënohet nga gjykata me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale kundrejt të miturve;

c) nëse është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale që lidhet me institucionet arsimore parauniversitare.

4. Largimi i mësuesit nga puna bëhet sipas procedurave të Kodit të Punës dhe akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

KREU 11 ANKIMI

1. Çdo kandidat ka të drejtën e ankimit për secilën prej fazave të zhvilluara për vendet e lira të punës për pozicionin e mësuesit, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

2. Ankimi i kandidatit protokollohet në institucionin ku bëhet ankimi, menjëherë pas shpalljes së vendimeve të komisionit/ve dhe jo më vonë se 3 (tri) ditë pune pas shpalljes së tyre.

3. Ankimi shqyrtohet nga institucioni në bashkëpunim me komisionin përkatës brenda 5 (pesë) ditëve pune.

4. Vendimi i arritur pas përfundimit të shqyrtimit të ankimit i bëhet i njohur ankuesit me shkrim nga institucioni.

5. Vendimet e institucioneve ankohen tek organi epror, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

KREU 12 DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

1. Procedurat e ndjekura, dokumentet e administruara dhe vendimet e marra për zbatimin e këtij udhëzimi ruhen në ZVAP dhe në DRAP dhe janë objekt monitorimi dhe inspektimi.

2. Për mësuesit në institucionet parashkollore, njësitë e vetëqeverisjes vendore kryejnë procedurat e emërimit duke respektuar renditjen në portalin “Mësues për Shqipërinë”.

3. Dosjet e aplikimit të kandidatëve për mësues ruhen për 10 vite shkollore nga shpallja përfundimtare e rezultateve të konkurrimit. Dokumentet e tjera të përcaktuara në këtë udhëzim ruhen për 10 vjet.

4. Drejtuesit e DRAP-ve nuk mund të pranojnë dorëheqjet e drejtorëve dhe nëndrejtorëve të institucioneve arsimore parauniversitare, pa i sistemuar më parë në vende pune të lira dhe me ngarkesë të plotë, brenda të njëjtës ZVAP-je, me përjashtim të rasteve kur drejtorët apo nëndrejtorët largohen nga sistemi arsimor sipas kuadrit ligjor në fuqi, nuk kanë 5 (pesë) vite përvojë pune si drejtor/nëndrejtor apo mësues, apo nuk plotësojnë kriteret ligjore për të qenë

mësues. Rastet e dorëheqjeve të drejtorëve dhe nëndrejtorëve të IA-ve, me kërkesën për sistemim si mësues, i paraqiten menjëherë komisionit të lëvizjeve paralele në ZVAP, gjatë apo ndërmjet viteve shkollore. Komisioni i paraqet kërkesat drejtorit të institucionit arsimor ku lirohet vendi më i parë i punës. Drejtorët dhe nëndrejtorët që kanë paraqitur kërkesën për dorëheqje, nuk mund të refuzojnë më shumë se 3 (tri) vende pune si mësues, të propozuara nga komisioni, dhe emërimi u bëhet pa afat nga drejtori i IAP-së përkatëse.

4/1 Përjashtimisht për punësimin e mësuesve në dispozicion për vitin shkollor 2023–2024, të gjithë mësuesve të renditur sipas profileve mund t'u ofrohet një vend pune si mësues në dispozicion krabas vendeve të lira apo vendeve të përkohshme të punës. Refuzimi i mësuesit për një vend pune si mësues në dispozicion, nuk përlllogaritet për efekt të pikës 5 të kreut 8 të këtij udhëzimi.

5. Udhëzimi nr. 13, datë 22.5.2019, i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë”, i ndryshuar, shfuqizohet.

6. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare publike.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Evis Kushi

SHTOJCË 1

1. Jetëshkrimi (dorëzohet në momentin e punësimit).
2. Kërkesa me shkrim për konkurrim sipas modelit të shtojcës 4, të këtij udhëzimi.
3. Kopje e kartës së identitetit (e detyrueshme për t'u ngarkuar *online*).
4. Raport mjekoligjor (i tre muajve të fundit dorëzohet në momentin e punësimit).
5. Vetëdeklarim për gjendjen gjyqësore, sipas shtojcës 5, të këtij udhëzimi (dorëzohet në momentin e punësimit).
6. Vërtetim i qendrës së banimit (i detyrueshëm për t'u ngarkuar *online*).
7. Kopje e librezës së punës (nëse ka dorëzohet në momentin e punësimit).
8. Kopje e diplomës/ave, vërtetimit/listës së notave të studimeve të larta (cikli i parë dhe cikli i dytë) ose të barasvlerëshme me këto sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi (i detyrueshëm për t'u ngarkuar *online*).
9. Kopje e licencës së provimit të shtetit për profesionin e rregulluar të mësuesit, për të gjithë kandidatët që kanë detyrim ligjor ta kryejnë këtë provim sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi (i detyrueshëm për t'u ngarkuar *online*).
10. Kopje e dëshmimeve të kualifikimit për kategoritë: “Mësues i kualifikuar”, “Mësues specialist”, “Mësues mjeshër” (nëse ka për t'u ngarkuar *online*).
11. Kopje e certifikatave me kredite të trajnimeve të kryera brenda dhe jashtë vendit. Certifikatat me kredite të trajnimeve të kryera brenda vendit të jenë ofruar nga MASR-ja, institucionet e varësisë ose nga agjencitë e akredituara nga MASR-ja (nëse ka për t'u ngarkuar *online*).
12. Kopje e dëshmisë së njohjes së gjuhës/ve të huaja (nëse ka, për t'u ngarkuar *online*).
13. Deklarim nga kandidati për autorizimin e DRAP-së që të shqyrtojë vërtetësinë e dokumenteve të paraqitura sipas shtojcës 6 të këtij udhëzimi (i detyrueshëm për t'u ngarkuar *online*).

Shënim. Dokumentet që ngarkohen në platformën e aplikimit *online*, janë të skanuara nga origjinali.

SHTOJCË 2

**KRITERET DHE SKEMA E VLERËSIMIT TË DOSJEVE TË KANDIDATËVE PËR
USHTRIMIN E PROFESIONIT TË MËSUESIT**

1	<p>Nota mesatare e studimeve të larta, e shprehur në numër me një shifër pas presjes dhjetore (nota mesatare e ciklit I + nota mesatare e ciklit II)/2, ose nota mesatare e studimeve të barasvlershme me to.</p> <p>Nota mesatare 5.00 - 5.50 = 0.5 pikë Nota mesatare 5.51 - 6.00 = 1 pikë Nota mesatare 6.01 - 6.50 = 1.5 pikë Nota mesatare 6.51 - 7.00 = 2 pikë Nota mesatare 7.01 - 7.50 = 2.5 pikë Nota mesatare 7.51 - 8.00 = 3 pikë Nota mesatare 8.01 - 8.50 = 3.5 pikë Nota mesatare 8.51 - 9.00 = 4 pikë Nota mesatare 9.01 - 9.50 = 4.5 pikë Nota mesatare 9.51 - 10.00 = 5 pikë</p>	0 . 5 - 5 pikë
2	<p>Kategoria e kualifikimit:</p> <p>a) Mësues i kualifikuar (kategoria III) 2-4 pikë (2 pikë për vlerësimin “Mjaftueshëm”, 3 pikë për vlerësimin “Mirë”, 4 pikë për vlerësimin “Shumë mirë” dhe “Shkëlqyeshëm”)</p> <p>b) Mësues specialist (kategoria II) 5-7 pikë (5 pikë për vlerësimin “Mjaftueshëm”, 6 pikë për vlerësimin “Mirë”, 7 pikë për vlerësimin “Shumë mirë” dhe “Shkëlqyeshëm”)</p> <p>c) Mësues mjeshtër (kategoria I) 8-10 pikë (8 pikë për vlerësimin “Mjaftueshëm”, 9 pikë për vlerësimin “Mirë”, 10 pikë për vlerësimin “Shumë mirë” dhe “Shkëlqyeshëm”)</p> <p>Për kandidatët që nuk e kanë në dëshmi nivelin e vlerësimit, do të llogaritet niveli “Shumë mirë”. Kandidati vlerësohet vetëm për kategorinë më të lartë të kualifikimit që zotëron.</p>	0 - 1 0 pikë
3	<p>Dëshmi të njohjes së gjuhës/ve të huaja:</p> <p>a) gjuhë e huaj e mbrojtur në IAL-të publike = 1 pikë; b) gjuhë e huaj e mbrojtur me testim ndërkombëtar niveli B2 = 2 pikë.</p> <p>Si gjuhë e huaj e mbrojtur llogaritet edhe rasti kur gjuha e huaj është e mbrojtur në kuadër të përfundimit të studimeve të ciklit të dytë, sipas legjislacionit përkatës. Dokumenti i gjuhës së huaj duhet të jetë lëshuar nga subjekte të njohura nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, për ofrimin e testeve ndërkombëtare dhe të jetë brenda afatit të vlefshmërisë. Lista e subjekteve është sipas udhëzimit nr. 52, datë 3.12.2015, i ndryshuar.</p> <p>Pavarësisht se kandidati mund të ketë disa gjuhë të huaja të mbrojtura, në këtë rubrikë nuk mund t'i llogariten më shumë se 2 pikë në vlerësimin e dosjes.</p> <p>Në rast se kandidati ka mbrojtur të njëjtën gjuhë të huaj në dy institucione të ndryshme, do t'i llogariten pikë vetëm për dëshminë me vlerësimin më të lartë.</p> <p>Kandidatit të profilit gjuhë e huaj, i njihen pikët e kësaj rubrike, përveç gjuhës së huaj për të cilën është diplomuar.</p>	0-2 pikë
4	<p>Trajnime:</p> <p>Vlerësimi bëhet sipas kësaj skeme:</p> <p>a) Certifikata trajnimesh me kredite të lëshuara nga institucione në varësi të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë ose nga agjenci trajnuese që janë akredituar nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p> <p>a. 1 kredit =1 pikë; b. 2 kredite =2 pikë; c. mbi 3 kredite = 3 pikë.</p>	0-3 pikë
5	<p>Përvoja në punë si mësimdhënës dhe/ose drejtues institucioni arsimor</p>	0.5 pikë për çdo vit pune

KRITERET DHE SKEMA E VLERËSIMIT TË DOSJEVE TË KANDIDATËVE PËR LËVIZJET PARALELE

1	<p>Nota mesatare e studimeve të larta, e shprehur në numër me një shifër pas presjes dhjetore (nota mesatare e ciklit I + nota mesatare e ciklit II)/2, ose nota mesatare e studimeve të barasvlershme me to.</p> <p>Vlerësimi bëhet sipas kësaj skeme:</p> <p>Nota mesatare 5.00 - 5.50 = 0.5 pikë</p> <p>Nota mesatare 5.51 - 6.00 = 1 pikë</p> <p>Nota mesatare 6.01 - 6.50 = 1.5 pikë</p> <p>Nota mesatare 6.51 - 7.00 = 2 pikë</p> <p>Nota mesatare 7.01 - 7.50 = 2.5 pikë</p> <p>Nota mesatare 7.51 - 8.00 = 3 pikë</p> <p>Nota mesatare 8.01 - 8.50 = 3.5 pikë</p> <p>Nota mesatare 8.51 - 9.00 = 4 pikë</p> <p>Nota mesatare 9.01 - 9.50 = 4.5 pikë</p> <p>Nota mesatare 9.51 - 10.00 = 5 pikë</p>	0.5-5 pikë
2	<p>Kategoria e kualifikimit:</p> <p>a) Mësues i kualifikuar (kategoria III) 2-4 pikë (2 pikë për vlerësimin “Mjaftueshëm”, 3 pikë për vlerësimin “Mirë”, 4 pikë për vlerësimin “Shumë mirë” dhe “Shkëlqyeshëm”)</p> <p>b) Mësues specialist (kategoria II) 5-7 pikë (5 pikë për vlerësimin “Mjaftueshëm”, 6 pikë për vlerësimin “Mirë”, 7 pikë për vlerësimin “Shumë mirë” dhe “Shkëlqyeshëm”)</p> <p>c) Mësues mjeshër (kategoria I) 8-10 pikë (8 pikë për vlerësimin “Mjaftueshëm”, 9 pikë për vlerësimin “Mirë”, 10 pikë për vlerësimin “Shumë mirë” dhe “Shkëlqyeshëm”)</p> <p>Për kandidatët që nuk e kanë në dëshmi nivelin e vlerësimit, do të llogaritet niveli “Shumë mirë”. Kandidati vlerësohet vetëm për kategorinë më të lartë të kualifikimit që zotëron.</p>	0 - 1 0 pikë
3	<p>Dëshmi të njohjes së gjuhës/ve të huaja:</p> <p>a) gjuhë e huaj e mbrojtur në IAL-të publike = 1 pikë;</p> <p>b) gjuhë e huaj e mbrojtur me testim ndërkombëtar niveli B2 = 2 pikë.</p> <p>Dokumenti i gjuhës së huaj duhet të jetë lëshuar nga subjekte të njohura nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, për ofrimin e testeve ndërkombëtare dhe të jetë brenda afatit të vlefshmërisë. Lista e subjekteve është sipas udhëzimit nr. 52, datë 3.12.2015, i ndryshuar.</p> <p>Pavarësisht se kandidati mund të ketë disa gjuhë të huaja të mbrojtura, në këtë rubrikë nuk mund t'i llogariten më shumë 2 pikë në vlerësimin e dosjes.</p> <p>Në rast se kandidati ka mbrojtur të njëjtën gjuhë të huaj në dy institucione të ndryshme, do t'i llogariten pikë vetëm për dëshminë me vlerësimin më të lartë.</p> <p>Kandidatit të profilit gjuhë e huaj, i njihen pikët e kësaj rubrike, përveç gjuhës së huaj për të cilën është diplomuar.</p>	0-2 pikë
4	<p>Trajnime:</p> <p>Vlerësimi bëhet sipas kësaj skeme:</p> <p>a) Certifikata trajnimesh me kredite të lëshuara nga institucione në varësi të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë ose nga agjenci trajnuese që janë akredituar nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p> <p>a. 1 kredit = 1 pikë;</p> <p>b. 2 kredite = 2 pikë;</p> <p>c. mbi 3 kredite = 3 pikë.</p>	0-3 pikë
5	<p>Përvoja në punë si mësimdhënës dhe/ose drejtues institucioni arsimor</p>	0.5 pikë për çdo vit pune
6	<p>Vlerësimi i përfaqësuesve të prindërve (sipas shtojcës 7)</p> <p>Përfaqësuesit e prindërve të nxënësve, ku mësuesi jep mësim, vlerësojnë punën e këtij mësuesi me nivelet: “Shumë mirë”, “Mirë”, “Mjaftueshëm”, “Dobët”.</p> <p>Vlerësimi “Shumë mirë” dhe “Mirë” = 2 pikë</p> <p>Vlerësimi “Mjaftueshëm” = 1 pikë</p> <p>Vlerësimi “Dobët” = 0 pikë</p>	0-2 pikë
7	<p>Vlerësimi nga punonjësi i shërbimit psikosocial</p>	0-2 pikë
8	<p>Vlerësimi i drejtorit të institucionit arsimor, bazuar në vlerësimin e performancës, e shprehur në nivelet: “Shumë mirë”, “Mirë”, “Mjaftueshëm”, “Dobët”.</p> <p>Vlerësimi: “Shumë mirë” dhe “Mirë” = 2 pikë</p> <p>Vlerësimi: “Mjaftueshëm” = 1 pikë</p>	0-2 pikë

SHTOJCË 3
FORMULAR I PJESËMARRJES NË TESTIMIN E INFORMATIZUAR

DRAP (vetëm për llogaritjen e pikëve të dosjes): _____

EMRI, ATËSIA, MBIEMRI: _____

ID: _____

PROFILI: _____

PIKËT E DOSJES (në rastet kur i mbart): _____

PIKËT E TESTIMIT (në rastet kur i mbart): _____

ZVAP-ja KU KËRKON TË PUNËSOHET:

1. _____
2. _____
3. _____

PËR KOMISIONIN E VLERËSIMIT TË DOSJEVE
KRYETAR
DREJTOR I DRAP-së
Emër, mbiemër, firma, vula

SHTOJCË 4
KËRKESË PËR KONKURRIM NË PORTALIN "MËSUES PËR SHQIPËRINË"

Unë _____ kërkoj të marr pjesë në konkurrimin "Mësues për Shqipërinë" për vitin shkollor _____ - _____ në DRAP _____.

Kërkesa për konkurrim bëhet për njërin nga rastet e mëposhtme:

- a) aplikoj për herë të parë;
- b) mbart pikët aktuale (dosje + testim);
- c) mbart vetëm pikët e dosjes;
- d) mbart vetëm pikët e testimit të fundit.

Kërkoj të konkurroj dhe të renditem për punësim në këto ZVAP:

1. _____
2. _____
3. _____

Tel.: _____; e-mail: _____

Emër, atësi, mbiemër

nënshkrimi

SHTOJCA 5
VETËDEKLARIMI I GJENDJES GJYQËSORE
(ndryshuar me udhëzimin nr. 23, datë 1.12.2021)

Të dhënat e vetëdeklaruesit:

Emër, atësi, mbiemër: _____

Datëlindja: _____

Vendlindja: _____

Dokumenti i identifikimit (kopje bashkëlidhur formularit)

Deklaroj me vullnetin tim të lirë se jam: _____

i/e padënuar

i/e dënuar

Deklaroj me vullnetin tim të lirë se nuk kam qenë asnjëherë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, për kryerjen e një vepre penale kundrejt të miturve apo për kryerjen e një vepre penale që lidhet me institucionet arsimore, apo i rehabilituar për këto vepra penale.

Emër, mbiemër: _____ Nënshkrimi: _____

Autorizim: Deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë formular janë të vërteta dhe autorizoj kontrollin e vërtetësisë së tyre nga institucioni arsimor vendor përgjegjës për arsimin parauniversitar.

SHTOJCË 6
DEKLARATË PËR VERIFIKIMIN E VËRTETËSISË SË DOKUMENTEVE TË
PARAQITURA NGA KANDIDATI

Unë _____, kandidat në procesin e konkurrimit për lëndën/profilin “_____”, të zhvilluar në vitin shkollor _____ - _____, autorizoj DRAP-në _____ të verifikojë në çdo kohë vërtetësinë e dokumenteve të paraqitura nga ana ime.

Deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë formular janë të vërteta dhe autorizoj kontrollin e vërtetësisë së tyre nga institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar.

Trajtimi i të dhënave personale në vijim të përdorimit të këtij autorizimi do të bëhet në përputhje me ligjin nr. 8517, datë 22.7.1999, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

AUTORIZUESI

SHTOJCË 7



MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR _____
ZYRA VENDORE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR _____
INSTITUCIONI ARSIMOR PARAUNIVERSITAR _____

Nr. _____ prot. _____, më _____.202_

PROCESVERBAL I DOKUMENTIMIT TË OPINIONIT TË KËSHILLIT TË
PRINDËRVE PËR MËSUESIN/EN _____
PROFILI _____,

Bazuar në ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në ligjin nr. 69/2012, datë 21.6.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në udhëzimin nr. _____, datë _____, të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë”,

Sot në datën _____.202_ ora ____:___ u mbledh Këshilli i Prindërve në shkollën _____ për të dhënë opinion për mësuesin/en, Z./Znj. _____, profili _____, dhe për performancën e tij/saj në procesin mësimor-edukativ, sjelljen dhe etikën në institucionin arsimor.

Në mbledhje morën pjesë _____ prindër nga _____ prindër gjithsej.
Opinionit i prindërve mbi mësuesin/en Z./Znj _____ është:
1. Dobët. 2. Mjaftueshëm. 3. Mirë. 4. Shumë mirë.

Anëtarët e pranishëm në Këshillin e Prindërve:

.....

Rezultati i vlerësimit për këtë mësues është: _____

U votua me _____ pro, dhe _____ vota kundër, me votim të fshehtë.

Mbajti procesverbalin

DREJTOR

SHTOJCË 8

DEKLARATË PËR ANGAZHIMIN SI MËSUES NË DISPOZICION *(shtuar me udhëzimin nr. 26.7.2023)*

Unë _____, kandidat në procesin e konkurrimit për lëndën/profilin “_____”, të zhvilluar në vitin shkollor _____-_____, deklaroj nën përgjegjësinë time personale se do të angazhohem të punojë si mësues në dispozicion në zyrat vendore të arsimit parauniversitar ku kam aplikuar, deri në ofrimin e vendit të punës në profilin përkatës.

DEKLARUESI

